

Rajonalizimi i Shërbimeve të UK në Kosovë

Implementimi i Procesit në Rajonin e Gjilanit

Mumin Morina
Afrim Lajçi

Aspektet institucionale dhe ligjore të procesit - REFORMAT e SEKTORIT -

- 'Procesi i konsolidimit' si **shtyllë kryesore e reformimit të sektorit** të shërbimeve të ujit në Kosovë.
- Definimi i kuadrit rregullator të shërbimeve të ujit dhe **themelimi i rregullatorit ekonomik (ZRRUM)** që në 2012 u transformua në Zyrën Rregullatore për Ujësjetë dhe Kanalizime (ZRRUK).
- Si rezultat i këtij procesi që u zhvillua gjatë 2003-2007, nga 25 ndërmarrje komunale të ujësjetës dhe kanalizimit u **krijuan 7 KRU**, të cilat u regjistruan si entitete të reja ligjore dhe mëpastaj u korporatizuan si shoqëri aksionare me qëllim të definimit të qartë të statusit të tyre ligjor dhe financiar

Aspektet institucionale dhe ligjore të procesit

- Me Ligjin për Ndërmarrjet Publike (neni 5) të dekretuar në vitin 2008, shumica e KRU-ve (6 prej 7) u kategorizuan si **ndërmarrje publike qendrore** mbi të cilat *Qeveria e Kosovës e ushtron të drejtën ekskluzive të pronarit* të aksioneve në emër të Republikës së Kosovës si pronare e vetme aksioneve të këtyre ndërmarrjeve.
- Vetëm **KRU Bifurkacioni** u kategorizua si **ndërmarrje publike lokale** në pronësi të komunave Ferizaj dhe Kaçanik duke u bazuar në faktin që ofron shërbime në më pak se 3 komuna që ishte përcaktuar si kufi ndarës ndërmjet ndërmarrjeve publike qendrore (3 më tepër komuna) dhe atyre lokale (më pak se 3 komuna)
- Ndërmarrjet e rajonalizuara ishin **licencuar nga ZRRUM**.

Qëllimi kryesor i rajonalizimit te KRU-ve

- Optimizimi i performancës operative dhe financiare në mënyrë që KRU-të të bëhen **financiarisht të vetqëndrueshme** dhe të jenë në gjendje ti përmbushin standardet e cilësisë së shërbimit
- Në vitin 2007 procesi ishte praktikisht i kompletuar derisa jashtë procesit kishin mbetur **vetëm komunat me shumicë serbe** të cilat për arsye politike nuk kishin aderuar në KRU

Vështërsitë në implementim

- Rajonalizimi ishte sfiduar me disa **tendenca të dezintegrit** të disa komunave (Deçani dhe Kaçaniku) të shfaqura gjatë viteve 2007-2009 të cilat edhe pse marginale ishin konsideruar si kërcënim serioz i procesit.
- **Disa komuna kishin kundërshtuar** procesin e rajonalizimit për motivet e mbajtjes së kontrollit mbi këto ndërmarrje duke e justifikuar kundërshtimin e tyre me trendet e përgjithshme të decentralizimit të shërbimeve, duke sugjeruar se me menaxhimin komunal këto shërbime janë 'më afër qytetarit'.
- **Integrimi i komunave të reja** të krijuara me procesin e decentralizimit pas vitit 2008 ishte një sfidë tjetër për përmbylljen e procesit të rajonalizimit.

Veprimet e ndërmarra për kompletimin e procesit

Vendimi i qeverisë për konsolidimin e KRU-ve

Qeveria e Kosovës nxorri një vendim (në qershor të vitit 2011) me të cilin përpos që u konfirmua përkushtimi i qeverisë për procesin e konsolidimit, u kërkua nga të gjitha komunat e paintegruara që të integrohen në KRU-të përkatëse, përfshirë:

- a) ato të cilat kishin braktisur në mënyrë të njëanshme KRU-të (Deçani dhe Kaçaniku),
- b) ato me shumicë serbe, si dhe
- c) komunat e reja të dala nga procesi i decentralizimit.

Veprimet e ndërmarra për kompletimin e procesit

Kushtëzimi i investimeve me integrimin në KRU

- Me qëllim që të motivohen komunat për tu integruar në KRU, qeveria e Kosovës në bashkëpunim me donatorët adoptuan çasjen e kushtëzimit të investimeve në rehabilitimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në komuna e paintegruara.
- Kjo çasje u zbatua në mënyrë eksplicite në projektin e realizuar në bashkëfinancim të qeverisë Zvicerane dhe qeverisë së Kosovës Mbështetja për Sistemet Rurale të Ujësjellësit dhe Sanitacionit, faza e V-të (RWSSP-V) projekt me vlerë rreth 20 milion EUR përmes të cilit parashihet rehabilitimi i të gjitha sistemeve rurale (dhe të komunave të reja/vogla) dhe integrimi i tyre.

Veprimet e ndërmarra për kompletimin e procesit

Masat ligjore të ZRRUK

- Në pajtim me mandatin e vet ligjor ZRRUK në vitin 2012 kishte inicuar procedurë administrative të gjobitjes së ndërmarrjeve komunale të ujësjellësit të cilat operonin pa licencë shërbimi.

Përfshirja e përfaqësuesve komunal në bordet e KRU-ve

- Me amendimin e Ligjit për Ndërmarrje Publike të bërë në vitin 2012 është afirmuar përfaqësimi i komunave në qeverisjen e KRU-ve. Kjo është bërë duke sanksionuar që gjysma e anëtarëve të Bordeve të KRU-ve duhet të nominohen nga komunat.

Efektet pozitive të masave të ndërmarra

- Si rezultat i këtyre masave, jo vetëm që u evitua rreziku i dezintegrimit të KRU-ve, por edhe u arritën rezultate konkrete në procesin e kompletimit të konsolidimit të KRU-ve:
 - **Ri-integrimi i komunave të Deçanit dhe Kaçanikut;**
 - **Nënshkrimi i marrëveshjeve të shërbimit ndërmjet KRU Hidromorava dhe 4 komunave të pintegruara: Novobërdë, Partesh, Klllokot, Ranillug;**
 - **Nënshkrimi i marrëveshjes së shërbimit ndërmjet KRU Bifurkacioni dhe komunës Hani i Elezit.**

Gjendja aktuale

- Aktualisht **33 prej 38 komunave** të Kosovës që përbëjnë shumicën dërmuese të popullsisë (97.4%) në Kosovë (1,727,687 prej 1,804,944 banorëve sa ka në Kosovë) janë të përfshira me procesin e rajonalizimit, respektivisht kanë marrëveshje të shërbimit me KRU-të.
- Kanë mbetur ende edhe 5 komuna (të gjitha me popullsi shumicë serbe), prej të cilave 4 janë në pjesën veriore të Kosovës që **përbëjnë 2.6% të popullsisë** (46,472 banorë) të cilat ende nuk kanë nënshkruar marrëveshje shërbimi me KRU-të përkatëse.

Zhvillimi i Procesit në Rajonin e Gjilanit

FAZA FILLESTARE E PROCESIT:

Integrimi i komunave të Vitisë dhe Kamenicës me Gjilanin

- Para Rajonalizimit të ndërmarrjeve komunale të ujësjellësit, tri kompanitë në tri qytete Gjilan, Viti dhe Kamenicë vepronin si plotësisht të ndara: Ujesjellesi i Gjilanit njihej me emrin “Hidroteknika”, ujesjellesi i Vitisë me emrin “Universali” si dhe ujesjellesi i Kamenices si “ Ndërmarrja Publike Komunale”.
- Procesi i rajonalizimit nuk ka qenë i lehtë dhe si i tillë fillimisht është pritur me skepticizëm si nga ndërmarrjet e ujësjellësit poashtu edhe nga vet komunat.
- Problemi dukej edhe me i vështirë duke marrë parasysh faktin se një pjesë e shërbimeve të ujërave te zeza ne atë kohë ishte pjesë e kompanive te cilat merreshin me menaxhimin e mbeturinave.

Zhvillimi i Procesit në Rajonin e Gjilanit

PËRMBYLLJA E FAZËS FILLESTARE TË RAJONALIZIMIT

- Faza fillestare e procesit të Rajonalizimit të ndermarrjeve komunale u permbylle me sukses me formimin e Kompanisë Regjionale të Ujesjellesit si entitet i ri me emrin KRUK “Hidromorava” në Gjilan
- Procesi është dizajnuar në atë mënyrë që në kuadër të sistemit më të madh të Ujesjellesit siç ishte Ujesjellesi i Gjilanit të bashkoheshin dy Ujesjellsa të qyteteve më të vogla në Viti dhe në Kamenice.
- I gjithë procesi i rajonalizimit ishte mbështetur fuqishëm nga Qeveria e Kosovës, Komuniteti dhe Qeveria zvicerane e cila që nga viti 2000 ishte donatori kryesor në Kosovën Jug-lindore.

Zhvillimi i Procesit në Rajonin e Gjilanit

FAZA E DYTË E PROCESIT:

Integrimi i komunave Novobërdë, Partesh, Kllokot dhe Ranillug

- Programi Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Viset Rurale faza-V zbatohet nga asociacioni i përbashkët Dorsch Group (nga Gjermania) dhe CDI (nga Kosova) dhe financohet nga Qeveria Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës.
- Pjesë e kërkesave të programit është që komunat ekzistuese që nuk shërbehen aktualisht nga KRU të hyjnë në marrëveshje të shërbimeve me KRU-të përkatëse për të ofruar shërbime të ujit dhe të kanalizimit.
- Për të siguruar se nuk ka çështje teknike që e parandalon integrimin, Programi Mbështetës krijuar grupe punuese të përbërë nga përfaqësuesi i KRUK-së “Hidromorava”, komuna përkatëse dhe përfaqësuesit e programit për lehtësimin e këtij integrimi.
- Detyra e grupit punues ishte që t’i identifikojë problemet dhe propozojë zgjidhje teknike, të cilat do të financohen përmes programit.

Zhvillimi i Procesit në Rajonin e Gjilanit

SFIDAT PËR KOMPLETIMIN E PROCESIT

- Bazuar në Studimin e mbulueshmërisë (CDI, 2012), në regjionin e Gjilanit janë identifikuar gjithsejt 62 sisteme të furnizimit me ujë të cilat duhet rehabilituar para se këto sisteme të integrohen nën menaxhimin e KRU Hidromorava.
- Deri më tani këto sisteme të furnizimit me ujë (rurale dhe urbane) kanë qenë të menaxhuara dhe operohen nga komuniteti ose komuna dhe janë përcjellur vazhdimisht me mangësi funksionale për shkak të operimit dhe mirëmbajtjes jo të rregullt dhe pamundësisë së sanimeve në kohë të sistemeve të lartëcekura.
- Për pasojë, rehabilitimi i disa prej tyre, është i domosdoshëm dhe urgjent për ti rikthyer sërish në gjendje funksionale dhe që komunitetet të vijojnë të furnizohet me ujë të pijshëm, në sasi të mjaftueshme dhe cilësi të garantuar.

Zhvillimi i Procesit në Rajonin e Gjilanit

KONKLUZION

- Siç është potencuar në tekstin më lartë, njëpjesë e sistemeve rurale dhe urbane të furnizimit me ujë për shkak të menaxhimit jo-adekuat kanë mangësi funksionale apo janë plotësisht jashtë funksionit.
- Qëllimi parësor i ***Programit Mbështetës për Ujë dhe Kanalizim në Zonat Rurale Faza e V-të***, që bashkë-financohet nga Qeveria e Zvicrës përmes Agjencisë Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës është rehabilitimi teknik i sistemeve të furnizimit me ujë që është edhe parakusht për integrimin tyre nën ombrellën e KRU “Hidromorava”.

Zhvillimi i Procesit në Rajonin e Gjilanit

PLANI I VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN e skemave të ujësjellësve të komunave

- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Shërbimit;
- Vlerësimi teknik dhe financiar i të gjitha sistemeve të furnizimit me ujë në Ranillug, Partesh, Novobërdë dhe në komunën e Kllokot-it;
- Tenderimi për rehabilitimin/përmirësimin e sistemeve të ujësjellësve;
- Zbatimi i rehabilitimit/përmirësimit të sistemeve të ujësjellësve;
- Pagesa e borxheve të energjisë elektrike;
- Krijimi i Njësive Operative të Ujit;
- Regjistrimi i konsumatorëve në bazën e të dhënave të KRUK “Hidromorava”;
- Regjistrimi i aseteve në KRUK “Hidromorava”.

Faleminderit për vemendjen tuaj!